

LIGJ
Nr.7604, datë 10.9.1992

PËR NJË SHITESË NË LIGJIN NR.7566, DATË 25.5.1992 "PËR ARMËT"

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I :

Neni 1

Në ligjin nr.7566, datë 25.5.1992 "Për armët", në nenin 7 shtohet shkronja "ç" me këtë përmbajtje:

"Personat fizikë që caktohen nga organet e sistemit bankar për shoqërimin e transportimin e fondeve monetare dhe për ruajtjen e rendit të brendshëm e sigurimin në objektet e shërbimeve bankare ku administrohen fondet monetare".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë.

Shpallur me dekretin nr.. datë të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha.